ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **VU644-23-14245-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ECO CLEAN & Energy;Dardania Shpk; Ibrahim Kurrumeli B.I.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapashticë e Eperme,
(Adresa)

Podujevë, 11000
(Vendi)(Kodi postar)

044/131-079
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Muhamet Muçiqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

muhamet.muqiqi@hotmail.com
(Adresa elektronike)

15.04.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

810431453 Eco Clean & Energy PODUJEVË

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 27.12.2023
Hapja e ofertave date. 05.02.2024
Njoftimi mbi vendimin e AK – B058 me date: 06.03.2024
Kërkesa për rishqyrtim nga **ECO CLEAN & Energy** **(Lideri i grupit) përmes e-prokurimi** me date: 11.03.2024
Aprovimi i KpR si pjesrisht te bazuar nga AK me date 14.03.2024 (kthehet ne rivleresim)
Ma daten 25.03.2024 (AK na diskriminon duke ju derguar vetem OE Dardani SHPK dhe jo komplet grupit dhe ne nuk kemi pranuar njoftim nga sisitemi dhe nuk kemi arrit te kapim afatin per pergjigjie me fajin e AK pasi qe na ka diskriminuar kur me sqarim ju eshte drejtuar vetem OE Dardani Shpk)
Njoftimi mbi vendimin e AK B58 me date 28.03.2024
Kerkesa per qasje ne dokumente sipas ennit 10 te LPP-se me date 29.03.2024 dhe AK nuk na jap qasje duke na diskriminuar dhe duke favorizuar OE te rekomanduar i cili eshte i papergjegjsehm dhe ne asnje menyre nuk mund te jete i pergjegjshem (eshte sqaruar ne KpR qe kemi bere me date 11.03.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Në hapjen e këtijaktiviteti te prokurimit nuk kemi marr pjesë sepse ishte elektronike përmes platformës e-prokurimi dhe konsiderojmë se ka qenëne rregull procesi i hapjes.
Por proces verbali i hapjes është ngritur ne platformën elektronike me date 05.02.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 11.03.2024 kemi bere kërkesën për Ri-shqyrtimi tek AK, kurse AK me datën 14.03.2024 nxjerr vendimin për aprovimin pjeseerisht te pretendimeve tona lidhur me këtë aktivitet te prokurimit. Mirëpo AK nuk shqyrton pretendimet tona fare vetëm arsyeton se ka respektuar LPP duke mos e trajtuar fare me çështjet e ngritura ne pretendimet tona ankimore dhe shqetësimet tona lidhur me ketër aktivitet te prokurimit edhe përkundër qe kemi argumentuar detajisht, AK ne arsyetim e potencon se projekti është i ngarkuar ne Platformën elektronike E-prokurimi, gjë qe eshte vleresuar ne shkleje te dispozitaveligjore te LPP. Pra Prap e rekomand per kontrat OE te njejtin dhe ne me date 02.04.2024 peresi kemi bere KpR dhe AK me date 05.04.2024 ne refuzon kerkesn per rishqyrtim duke mos i trajtuar fare pretendimet tona ankimore

Pra me fjale tjera AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim ne kundërshtim me **nenit 108/A par. 9 dhe 12**dhe aty mundohet te arsyetoj shkeljet qe kane ndodhur ne vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, sepse përkundër qe kemi kërkuar mënyrën se si ka llogaritur komisioni i vlerësimit piket tona sepse AK - ZPP është shume i vetëdijshëmpërshkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

KOMUNA E VUSHTRRISË, ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si ne vijim:

1. **Neni 1 të LPP-së**
2. **Neni 2 të LPP-së**
3. **Nenin 6 të LPP-së**
4. **Neni 7 të LPP-së**
5. **NENIN 10 te LPP-se**
6. **Neni 51 par. 3 të LPP-së.**
7. **Neni 52 par. 3 te LPP-së**
8. **Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së**
9. **Nenin 61 te LPP-se**
10. **Nenin 60 te LPP-se**
11. **Nenin 72 te LPP-se**
12. **Neni 17.26 të Rreg. Nr. 001/2022 per Prokurim Publik**
13. **Neni 17.27 të Rreg. Nr. 001/2022 per Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do tëkthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kaneqenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK – **KOMUNA E VUSHTRRISË,** me date 28.03.2024, përmes platformës elektronike e-prokurim ka publikuar njoftimin per dhënien e kontrates – njoftimin mbi vendimin e AK B058 duke rekomanduar per dhenie te kontrate GOE NNP HYSNIA & POUK Group SHPK, i cili eshte i pa pergjegjshem dhe nuk ka arritur te plotësoj kriteret e përzgjedhjes si dhe kërkesat ne njoftimin per

kontrate dhe dosje tenderit si dhe ka ofertuar me cmime jo-normalisht te uleta per kete AP, ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se, andaj NE do ti theksoje pretendimet tona ankimore sikurse ne vijim:

Pretendimet tona ankimore per këtë AP: per GOE <u>GOE NNP HYSNIA & POUK Group SHPK</u>

<u>Pretendimi nr. 1</u>

Pas ngarkimit ne platformen elktronike e-prokurim te B58 njoftimit mbi vendimin e Ak ku eshte shpallur perseri GOE NNP Hsnia & POUK Group Shpk me date 28.03.2024 per dhenie te kontrates, ne me date 29.03.2024 kemi kerkuar qasje ne dokumente sipas nenit 10 te LPP-se duke sqaruar se AK te na i dergoj permes e-maili apo/ose permes platformes elektronike sepse koha kur eshte shpallur vendimi B5 eshte kufizim sepse perveq dites se PREMTE qe ka qene dite pune ditet tjera jan dite pushim dhe dita e fundit per KpR eshte dita e MARTE date 02.04.2024 (per shkak te festave zyrtare). Andaj AK e ka menduar dhe planifikuar ne detaje kete kufizim dhe marr per baze **nenin 10 te LPP-se** AK eshte i obliguar qe qasjen te ne mundesoj edhe permes e-mail apo edhe platforme pa qene nevoja te jemi fizikisht ne zyret e AK – krejt kjo fale **nenit 10 te LPP-se.....** Mirepo AK na dikriminon dhe e favorizon hapur GOE te cilin e ka shpallur perseri per dhenie te kontrates dhe sipas qasjes qe ne kemi pasur para KpR qe kemi ngritur me pretendimet tona dhe te cilat perseri po pretendojm se edhe nese ka pasur sqarime **KY GOE NUK KA MUNDUR TE BEHET I PERGJEGJSHEM SEPSE EDHE NESE KA DOREZUAR SQARIME KREJT KETO SQARIME JANE NE KUNDERSHTIM ME NENIN 72 PAR. 3 TE LPP-se, SEPSE DOKUMENTET DHET TE DESHMOHEN PARA DATES SE HAPJESE DHE PAS KESAJ DATE, ANDAJ NE JEMI DISKRIMINUAR DUKE NA PAMUNDESUAR TE REKOMANDOHEMI PER DHENIE TE KONTRATES, ANDAJ NE DO TE KONSULTOHEMI EDHE ME AVOKATIN TONE PER MBROJETUR DREJTAT TONE PASI QE KONSIDEROJM SE JEMI DISKRIMINUAR HAPUR NGA AK DHE DO TE JU DRETOHEMI ORGANEVE KOMPETENTET PER KETO VEPRIME TE AK. ESH ti shpaloz keto fakte dhe prova tona dhe te rekomdoj per anulimin e vendimit B58 dhe lenda te kthehet ne rivleresim pasi vetem GOE yne eshte i pergjegjshem ne kete AP.**

<u>Pretendimi nr. 2</u>

AK – komisioni i vlerësimit ka rekomanduar per dhenie te kontrates nje OE te papergjegjshem dukemos i kërkuar fare sqarime sipas nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41.3 te Rregullore Nr. 01/2022 per prokurim publik edhe per kunder se jan plotesuar te gjitha kushtet per kërkuar sqariem po ofrojm fakte dhe deshmi si me poshte:

Vlera e parashikuar: 180,543.80

Nr.	**AP**			
	A	**B**	**C**	**D**
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 3 oferta**		
2		1	166,809.52	
3		2	**89,592.00**	
4		3	169,096.00	
8		**Total(C2+C3+C4)**	**425,497.52**	

9		**mesatarja (C8/3)**	**141,832.51**	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**109,101.93**	ne ketë rast oferta 3 e permbushin kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**151,645.02**	ne ketë rast oferta 3 përmbush edhe kushtin e trete
Pretendimi yne lidhur me cmimet jo normalisht te uleta:				

Këtu plotësohen te tri (3) kushtet për çimim jo normalisht të ulet! Për ofertën nr. 2 ne pajtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.3 të Rregulloren Nr. 01/2022 per Prokurim Publik.
Me fjalë tjera oferta nr. 2 ne vlere: 89592.00 € i plotëson te tri (3) kushtet për ta eleminuar si ofertë jo normalisht të ulët në këtë aktivitet të prokurimit.

Nr.	*Përshkrimi i pozicioneve*	*Njësia Matëse*	*Sasia indikative 24 muaj*	*Çmim i për njësi pa TVSH*	*Norma e TVSH-së në %*	*Çmimi për njësi (me TVSh)-€*	*Totali (Pa TVSH)*	*TVSH*	*Totali (me TVSH)-€*
I	**MIRËMBAJTJA DIMËRORE**								
1	Furnizimi, transporti dhe hedhja e kripës.	Ton	678.00	25.42	**18.00**	**30.00**	17,237.29	3,102.71	**20,340.00**
2	Furnizimi, transporti dhe hedhja e rërës.	m³	339.00	6.78	**18.00**	**8.00**	2,298.31	413.69	**2,712.00**
3	Puna efektive e kamionit 1	Orë	330.00	50.85	**18.00**	**60.00**	16,779.66	3,020.34	**19,800.00**
4	Puna efektive e kamionit 2	Orë	330.00	42.37	**18.00**	**50.00**	13,983.05	2,516.95	**16,500.00**
5	Puna efektive e kamionit 3	Orë	330.00	25.42	**18.00**	**30.00**	8,389.83	1,510.17	**9,900.00**
6	Puna efektive e kamionit 4	ore	330.00	16.95	**18.00**	**20.00**	5,593.22	1,006.78	**6,600.00**
7	Puna efektive e ngarkuesit 1	Orë	133.00	25.42	**18.00**	**30.00**	3,381.36	608.64	**3,990.00**
8	Puna efektive e ngarkuesit 2	Orë	133.00	4.24	**18.00**	**5.00**	563.56	101.44	**665.00**
9	Puna efektive e ngarkuesit 3	Orë	133.00	4.24	**18.00**	**5.00**	563.56	101.44	**665.00**
10	Transportues për transportimin e borës nga rrugët dhe trotuaret e qytetit 2	Orë	140.00	1.69	**18.00**	**2.00**	237.29	42.71	**280.00**
11	Mini eskavator për pastrimin e trotuareve	Orë	140.00	8.47	**18.00**	**10.00**	1,186.44	213.56	**1,400.00**
12	Puna efektive e eskavatorit me zinxhirë (vemza)	Orë	40.00	4.24	**18.00**	**5.00**	169.49	30.51	**200.00**
13	Kujdestaria aktive	Orë	660.00	0.85	**18.00**	**1.00**	559.32	100.68	**660.00**
14	Kujdestaria pasive	Orë	2,940.00	1.69	**18.00**	**2.00**	4,983.05	896.95	**5,880.00**
	TOTALE ME TVSH					**VLERA**	**75,925.42**	**13,666.58**	**89,592.00**

Pozicioni me nr. 1 me cmime prej : 30.00 Euro eshte cmim jo normalisht I ulet per faktin se ne po bashkangjesim Profaturen nga ku edhe furnizohemi: dhe kur te llogaritiet 1 ton krip kushton 35 euro ne Vlore Shqiperi, + dogana dhe TVSH: 10.50 euro + transporti 40 euro per ton totali dele: 85.50 Euro vetem furnizimi, pa llogaritu transportin dhe hedhjen per rruget qe do mirembahen ne teritorin e komunes se Vushtrrise, prandaj cmimi i dhene nga OE NNP HYSNI eshte cmim jo normalisht i ulet, Lusim AK - komisioni e vleresimit te hulumtjn dhe analizojne ashtu sic i obligon LPP-se gjate vleresmit te tendereve dhe te konstatohet se cmimiprej 30 Euro eshte vertet qesharak dhejo normalisht i ulet sepse vetem blera ne vend VLORE kushton 35 Euro. **Prove: profatura nga furnizuesi yne!.**

Pozicioni me nr. 2 me cmime prej : 8 euro e reres vetem blerja e reres kushto prej 8 EURO deri ne 10 EURO pa llogaritur transportin dhe hedhjen e reres. Prandaj edhe ky cmime eshte jo normalisht I ulet dhe jo cmim i tregut. Lusim AK – KV te hulumtojn cmimet e tregut??!.....Jemi brenda vleres se parashikur nga AK dhe kemi ofruar cmime reale pasi qe jemi te specializuar ne keto sherbiem!.....

Pozicionet 3, 4, 5 dhe 6 jan cmime manipulatve pasi qe nuk jane cmime identike sepse behet fjale "**puna efektive e kamionit"** si mund te dalloj ky cmim ne keto sherbime perveq se jane cmime manipulative gje qe e ban te pa zbatushme kontraten dhe dyshim per korrupsion, Shikoni cmime tona jan identike per keto pozicion ne vlere 25 euro jane reale te tregut dhe jo manipulative!...

Pozicionet 7, 8, dhe 9 jan cmime manipulatve pasi qe nuk jane cmime identike sepse behet fjale **"puna efektive e ngarkuesit"** si mund te dalloj ky cmim ne keto sherbime perveq se jane cmime manipulative gje qe e ban te pa zbatushme kontraten dhe dyshim per korrupsion, Shikoni cmime tona jan identike per keto pozicion ne vlere 40 euro jane rale te tregut dhe manipulatve!... Hulumtone tregun!...

Pozicionet 13 janë cmime jo normalisht te uleta sepse kujdestaria aktive me cmim prej 1 euro eshte qesharak dhe absurde duke marr per baze se AK tek kriteret e perzgjedhjes konkretisht kerkesat mbimundesit teknik dhe profesional te FDT-se ka kerkuar: *Kërkesa 4. Operatori ekonomik dueht të ketë stafë teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum nezet (20) Puntorë teknik - ndhimës*. Prnadaj ku eshte logjika e shnosh ndash me ore me llogarit por edhe me dite eshte e pamundur te mbulohen vetem pagat e puntoreve qe do te jene ne gjendje gateshim per angazhimin ne kete pozicion per kete sherbim te kesaj natyre, ska punetore me ore prej 1 euro qe paguhet sepse kjo perban edhe shkelje e ligjit te punes dhe shkelje e **nenit 61 LPP-se, si dhe nenit 17.26 dhe 17.27 te Rregullores Nr. 001/2022** per prokurim publik sepse nuk mbulohen pagat e punetoreve, LUSIM AK TE ANALIZOJ DHE TE KONSTATOJ KU KA PUNETORE QE PAGUHET PER ORE PREJ 1 EURO ORA, DUKE MOS HARRUAR SE PUNEA E NATES DHE PUNA E WEKENDEVE DHE FESTAVE PGUHEN SIPAS LIGJIT TE PUNES ME 50% DHE 30% ME SHUME?????!!!..... Keto cmime jan qesahrak dhe sigurisht jo normalisht te uleta dhe me automatizem ky GOE eshte i pa pergjegjsehm sipas **nenit 61 te LPP-s**e, sepse nuk mbulan as pagat e punetoreve dhe kete e rregullon LPP se per pozicion qe nuk mbulhen pagat apo nuk mbrohen te drejtat e punetoreve OE duhet te eleminohen dhe te shpallen te papergjegjshem sipas **nenit 61 LPP-se, si dhe nenit 17.26 dhe 17.27 te Rregullores Nr. 001/2022 per prokurim publik.** Por AK - Komisioni i vleresimit, gjate kohese sa kemi qen ne qasje nuk na kane dhene deshmi se AK - Komisioni i vleresimit ka kerkuar sqarime per cmime jo ormalisht te uleta, qe do te thote se Komisioni i vleresimit ka qene jo proefsinal ku sipas **nenit 59 par. 1 te LPP-se, dhe rregulloren 39.5 te RR. Nr. 001/2022 per PP** sepse komisioni i vlerësimit duhet te posedoje aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit, dhe te repsektoj dispozite ligjre te LPP-se, konkretisht nenin 59 te LPP-se te vleresoj , ekzaminoj dhe krahasoj tenderet ne baze te njoftimit per kontrate dhe dosjese se tenderit, gje te cilen Komisoni vleresimit nuk e ka bere a deshtuar dhe ka vepruar ne Kundershtim me nenin 59 par. 4 te LPP-se, duke qene subjektiv dhe te njeaneshm me rastin e rekomandimit te OE NNP HYSNI - Kete pretendim tone e argumenton edhe Raporti i vleresimit i nenshkruar nga Komisioni i vleresimit se nuk ka kerkuar faqre sqarime dhe duke shkelur edhe nenin 7 te LPP-se duke ne diskriminuar dhe favorizuar OE i cili vepron ne komunen e tyre dhe i cili nuk eshte i specializuar ne kryerejn e ketyre sherbimeve, por eshte favorizuar ne shkelje te **nenit 7 te LPP-se**. **NUK E KEMI PAS MUNDEISN TE SHIKOJM PERGJIGJIEN QE KA DHENE OE I REKOMANDUAR, NESE AK I KA KERKUAR SQARIME, POR NUK KA MATEMATIK QE E BEN TE PERGJEGJSHEM SEPSE CMIMET E TREGUT SHUME LEHTE VERTETOHEN DHE ARGUMENTOHEN NE KEMI PROVA DHE FAKTE TE CMIMEVE TE TREGUT – KETE E DSHMON EDHE NENI 41 I LPP-SE, DHE CMIMET QE KEMI TENDERUA NE.**

AK e favorizon OE e rekomanduar per kontrate pasi qe jan plotesuar te gjitha kushtet te elemniohet se tenderus me cmiem jo normalisht te uleta dhe rezikon te hyje ne mardhenie kontraktual me nje OE i cili nuk do ta realizoj pasi qe me ato cmime me te uleta se cmimet e tregut nuk do te ekzekutohen.

Pretendimi nr. 4

AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar

kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte:

Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale 216,000.00 Ne rastet e ofertimit si Grupi I OE-ve, nga lideri I grupit kerkohet qe ta permbush min 60% te vlerese se kerkuar .	Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje me sukses te punëve.

Ndera AK – Komisoni i vlerësimit ka rekomanduar per dhenie te kontrates nje GOE i cili perveq qe arrin te plotësoj kete kërkese, sipas qasjes qe kemi pranuar AK i ka kërkuar edhe sqarime OE per te sjelle nje referenc per nje AK i cili fare ska te beje me natyren e ketyre shërbimeve, dhe as qe mund te quhet i ngjashem apo i perafert sepse me nje klikim ne platformen elektronike e gjeni kete kontrate dhe paramane qe ka realizuar me komune e obiliqit dhe asnjë pozicion ska te beje as per se afermi dhe nuk mund te pranohet se kontrate e ngjashme sepse kjo posedon numrin 5-2-1 qe dot e thote eshte PUNE dhe nuk eshte sherbim fare dhe sigurisht nuk arrin te plotësoj kerkesen 1 dhe deshmin 1, pasi qe kjo kontrate eshte pune dhe nuk hyne te shërbimet dhenuk mund te pranohet si kontrate e ngjashme. Perveq kësaj kjo reference e pranuar nga Komisioni i pranimit (***i cili komisionka qene jo profesional sipas nenit 59 par. 1 te LPP-se***) edeh pas sqarimet e pranuar nga OE NNP Hysnia, me rastise pranimit ka shkelur edhe **nenin 72 par. 3 te LPP-se, ku thote:** *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*.**,** sepse ku reference mban daten 26.02.2024 kur eshte leshuar dhe ky dokument sigurisht perbene ndryshim material dhe nuk eshte i pranushem?!.....

Edhe pas aprovimit te kerkes tone per rishqrtim nga AK dhe ne raste te sqarimve per OE te rekomanduar per dhenie te kontrates perseri ky OE nuk ka mundur te behet i pergjegjshem sespe nuk ploteson kerkesn per kontrata te ngjashme dhe punet e ndertimit te ulet nuk jane kontrata te ngjashme dhe ky OE posedon vetem nje referen per pastrim bore dhe e cila nuk arrin vleren e percaktuar nga AK 216000.00 Euro. ESH te treajtoj drejt dhe te shtjelloj drejt pretendimet tona si dhe PSH te konstaton se jemi diskriminuar dhe eshte favorizuar OE i rekomanduar per dhenie te kontrates.

Prove: Paramasa dhe parallogarit e kësaj kontrate si ne vijim:

Rekapitulimi		**Shuma/Total (€)**
1	**Punët e mbushjes dhe zhavorit**	- €
2	**Punët e Betonit**	- €
3	**Punët e Armimit**	- €
4	**Punët e Muratimit dhe Suvatimit**	- €
5	**Punët e Kulmit**	- €
6	**Punët e Fasadës**	- €
7	**Kubëzat e betonit dhe shtruarja në rrugë,parkingje dhe staza**	- €
8	**PUNËT E ZDRUKTHTARISË | DYERT, DRITARET**	- €
9	**Betonimi I murit mbrojtës dhe mobilari urban**	- €
10	**Lojrat për këndin e fëmijëve**	

		- €
11	Dyshemeja prej gome	- €
12	Gjelbrimi	- €
13	Ndriçimi	- €
14	Punët e pusetave dhe bunarit	- €
15	Rrethoja e parkut	- €
	TOTALI	**- €**

Pra me kete veprim nga AK – Komisioni i vlerësimit cili nga keto pune mund te pranohet si kontrata dhe referenca (*ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se*) se jane te ngjashme, kjo nuk do komenet se ketu ska te beje fare me kontrate te ngjashme por AK ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 7 dhe 59 te LPP-se,** duke na diskriminuar dhe duke favorizuar GOE per dhenie te kontrates edhe perkunder se nuk a arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes te percaktuar ne dosje te tenderit per kete AP.

Pretendimi nr. 5

AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte:

Kerkesa 2.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar nga organi kopentent (MPMS) . Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të këtë kryer vlersimin e rriskut	Deshmia 2.Vlersimi i rriskut per kompani te deshmohet me vertetim nga nje kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS) se ka kryer vlersimin e rriskut konform ligjit 04 L-161 vertetimi duhet te jete i noterizuar) - Liderin.

AK ka rekomanduar per kontrate OE NNP Hysnia i cili ka ofruar kete dokumente dhe i cili nuk eshte sipas kërkese dhe deshmise si me lert te kërkuar ne dosje tenderit, pasi dokumenti mbi vleresimin e rrisut – **VERTETIMI nuk eshte i noterizuar**, po ashtu mungon edhe licnca e kompanise qe ka leshuar kete vertetim pasi qe sipas l*igjit Nr. 04/L-161* keto kompani duhet te kene licenca per keto pune??? dhe AK – komision i vlerësimit nuk ka vleresuar drjet me rastin e pranimit te këtij dokumenti duke shkelur **nenin 7 te LPP-se dhe nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se, duke kërkuar sqarime por me kusht qe keto sqarimet e jene ne pajtim te plote me nenin 72 par. 3 te LPP-se,** andaj me kete veprim AK – komisioni vlerësimit kane qen subjektive duke favorizuar OE NNP Hysnia duke shkelur dispozitat ligjore te LPP-se.

Ky dokumente edhe nese ka qene i noterizuar para dates se hapjes eshte ne rregull por nese ka dorezuar daten e noterizimit pas dates se hapjese eshte ndrshim material sipas nenit 72 par. 3 te LPP-se. AK nuk ak respektuar keto dispozita te LPP-se duke ne diskriminuar ne si OE pale me interes ne kete kete aktivitet te prokurimit, dhe duke e favorizuar OE te rekomanduar per kontrate.

Pretendimi nr. 6

AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte:

Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të angazhoj këtë staf profesionale në veçanti, të personit që drejtpërdrejt është përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore; Një (1) Bachelor i Ndërtimtarisë apo master, (drejtimi Konstruktiv), i emëruar me vendim menaxher dhe përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit.	Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listes duhet të i bashkangjiten këto dëshmi **CV-ja e nënshkruar nga inxhinieri**; Diploma, duhet të jetë e noteruar; Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi si dhe e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëdhënësi. Vendimi mbi emrimin e menaxherit të projektit i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur.

AK – komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka shkelu nenin 59 te LPP-se, pasi qe CV-ja per Inxh. z.Azem gashi nuk eshte e nenshkruar nga Inxh. dhe kjo ka qene kërkese ne dosje te tenderit, andaj komisioni vlerësimit eshte dashur te lenoj kete OE si te papergjegjshem sepse nënshkrimi i CV-se nuk eshte dokument qe mund te konstatohet se ka ekzistuar para dates se hapjes ashtu sic obligon nenin 72 par. 3 i LPP-se, andaj me kete veprim AK – Komisioni i vlerësimit konstatohet se perveq qe ka qen jo profesional ai ka qene edhe subjektive me rastin e vlersimit duke rekomanduar nje OE te papergjeshem per dhenie te kontrates.

Edhe nese eshte dorezuar CV e nenshkruar nga INHX... perseri paraqet ndrshim maetial sipas nenit 72 par. 3 te LPP-se dhe lejmi i keti veprim nga AK eshte ne kundershtim me nenin 7 dhe 59 te LPP-se. AK – Komisioni i vleresimit ka shkelur keto dispozita ligjore te LPP-se duke e favorizuar OE te rekomanduar per kontrat duke na eleminuar dhe diskriminuar ne kundershtim me dispozitat ligjore te LPP-se.

Pretendimi nr. 7

AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte:

Kërkesa 4. Operatori ekonomik dueht të ketë stafë teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum nezet (20) Puntorë teknik - ndhimës.	Dëshmia 4. **Lista e punëtorëve teknik me të dhënat e tyre e nënshkruar dhe e vulosur,** të cilët duhen dëshmuar me Kontratë të punës apo Parakontratë të punës të **nënshkruar nga Punëdhënësi dhe Punëmarrësi** si dhe e vulosur nga Punëdhënsi.

AK ka rekomanduar per dhenie te kontrates GOE NNP Hysnia & POUK Group SHpk te cilet jane te pa pergjeshem sepse OE NNP HYSNIA ka sjelle listen e stafit me nr. rendr 20, por nga kjo liste jane 6 inxhiner (ketu hyn dhe menaxheri i kontrates) qe dot e thote se ne kete liste jane 14 puneotre teknik – ndihmes, ndera antari tjetre POUK Group Shpk ka dorezuar nje liste te stafit me nr. rendor prej 5 veta mirëpo dy (2) veta jan inxhiner ndersa tre (3) veta jane staf teknik ndihmes, qe dot e thote se komplet ka prezantuar vetem 17 punetore tenik – ndihmes, perveq këtaj punëtori z, Arbore Sabani nuk e kat e nenshkruar kontratën qe dot e thote se kjo kontrate eshte e falsifikuar dhe e papranusme duke marr per baze kerkesen dhe deshmin e dosjes se tenderti si melart qe dot e thote se **AK – komisioni i vlerësimit me kete veprim ka shkelur nenin 7 dhe nenin 59 te LPP-se**, duke e rekomanduar per dhenei te kontrates nje GOE te papergjeshem pasi qe i njëjti nuk ka arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes dhe eshte admnistritivisht i pa prgjegjshem dhe nuk mund te aplikohet neni 72 i LPP-se.

Bazuar ne qasje qe kemi qene ne vleresim e pare eshte konstatur se i mungon nr. i punetoreve dhe nese ka dorezuar pas dates se hapjes tjer punetore eshte shkelje e nenit 7, 59 dhe 72 te LPP-se. Kerkojm nga ESH te analizoj dokumentet dhe provat ne platformen elektronike dhe dokumentet e ofruar nga OE i rekomanduar per kontrat dhe te konstatoj se eshte OE i

papargjeshem pasi qe nuk ka arrit te pleotesoj kriteret e perzgjedhjes dhe kriterin e dosjeses se tenderit.

Pretendimi nr. 8

AK ne dosje te tenderit si dokument themelor per pergaditjen e tendereve nga OE ke percaktuar kërkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se tek kerkesa 1/dëshmia 1 ka percaktuar si me poshte:

Kerkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT	Dëshmia 5. Lista për makanizimin dhe paisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe listes duhet ti bashkangjitet **Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen deklaron se i posedon makinerit dhe paisjet e listuara ne Aneksin nr.7 te DT_s** .ndërsa, makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me njërën prej këtyre dëshmive **kopje të librezës së qarkullimit**, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata apo marrëveshje mbi qiramarrjen të cilës duhet ti bashkangjitet edhe dokumenti i automjetit me të cilën dëshmohet pronësia në emër të qiradhënësit,**Vërejtje Automjetet duhet të jenë me librezë dhe me regjistrim valid.**

AK ka rekomanduar per dhenie te kontrate GOE i cili eshte i papergjegjshem pasie nuk ka arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes duke prezantuar dy (2) traktore te cilet nuk jane te regjistruar – dmth mungojne librezat e qarkullimit dmth automjete te cilat dalin ne qarkullim jane te obliguar tek ene regjistrim valid, andaj traktorat e prezantuar nga OE pa libreze qarkullimi eshte nekundershtimem dosjene tenderit si sipas ligjit mbi qarkullimin e mjeteve metrik ku thote: *çdo mjet bujqësor që është në qarkullim qoftë dhe në periudha sezonale duhet të jetë i regjistruar dhe kjo është një praktikë që zbatohet pothuajse në të gjitha vendet e BE-së*. Po ashtu bazuar ne **ligjin Nr. 05/L-132 per automjete** traktoret duhet te regjistrohn nese dalin qarkullim ne rrugen rajonal dhe lokala, andaj kryerja e natyres se kësaj kontrate me traktor pa libreze qarkullimi eshte e ndaluar me ligjin e cituar me lart per automjete si dhe AK vete e ka percaktuar se automjete duhet te jene me libreze dhe me regjistrim valid, andaj me kete veprim AK – komisioni i vlerësimit ka shkelur **nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se**, pasi qe nuk ka kërkuar librezen e qarkullimi valid ashtu sic e ka percaktuar ne dosjen e tenderit ne pajtim me **nenin 72 par. 3 te LPP-se.**

AK – Komisini i vlerësimit me rastin e rekomandimit te GOE per dhenie te kontrates i cili nuk ka dorezuar deklaraten te nenshkruar dhe te vulosur me te cilen deklaron se i posedon makinerin dhe paisjet ashtu siq e ka kërkuar ne dsje tenderit kerkesa5/deshmia5 ne dosje tenderit, dmth i mungon kjo deklarat ashtu sic eshte kërkuar ne dosje te tenderit dhe me kete veprim AK – ZPP si dhe Komisioi i vlerësimit kane shkelur nenin 7, 59 dhe 60 te LPP-se duke rekomanduar nje GOE te pa pergjegjshem dhe i cili nuk ka arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes si dhe ka tenderuar me cmime jo normalisht te uleta dhe manipulative gje qe e bene nje kontrate te demeshme, te pa zbatueshme dhe demshme sepse nuk ka kapacitet as profesional , as teknik dhe fuqi punetore per te ofruar shërbime te mirëmbajtjes dimore gje qe paraqet rrezik per shëndetin e qytetareve ne Komunen e Vushtrrise, prandaj kjo prek edhe interesin publik andaj lusim AK te analizoj dhe te respektoj ne tersi dispozitat ligjore te LPP-se, duke analizuar dhe hulumtuar tregun dhe cmime me te cilat kemi ofrtuar ne kete AP brenda vleres se parashikuar nga vete AK – NJK ne kete procedure prokurimi.

Gjithashtu, GOE i rekomanduar per kontrate edhe i papergjegjeshm per faktin se i mungon ngarkuesi pesha min. 2000Kg, qe dot e thote se nuk e plotëson kete kërkese dhe i shte i papergjegjshem.

Pretendimi nr. 9 lidhur me GOE: Çlirimi 99 SHPK & Fidai Bytyci B.I.

Ne pajtohemi me AK me rastin e eliminimit te këtij GOE te cilet nuk kane arritur te ploteojn kriteret e përzgjedhjes te percaktuar ne dosjen e tendrit si dokument themelor per pergaditejn e tendreve nga OE, dhe konsiderjm se ky GOE jane te papergjegjshem dhe nuk kane Intere juridik material sipas nenit 4 par. 1.26 te LPP-se.

Po shtune prteojm se ky GOE jane te pa pergjegjsehm edheper faktin se me rastin e tdenderimti ne kete AP e bejne edhe akoma me te papergjegjshem sepse i mungojne edhe dok si ne vijim:

1. **Mungojne punetoret teknik ndihmes ashtu si qeshte kërkuar ne dosje tenderit**
2. **Mungon noterizimi i vlerësimit te rriskut**
3. **Mungojn libreza e qarkullimit –valide e traktorit 4x4 dhe e traktorit per patrimin e bores**
4. **Mungon Luga ngarkuse min 5 ton**
5. **Mungon kamioni kiper me peshe bartese min. 17 ton (2 cope)**
6. **Mungon eskavatori deri min. 1.5 ton**
7. **Mungon deklarat me shkrim ku deklaron se i posedo makinerit dhe paisjet e kërkuar neaneksin 7 te FDT-se**

Prnadaj, bazuar ne keto fakte dhe deshmi qe i mungojne këtij GOE e te cilat e bejne te papergjegjshem sepse nuk arrin te plotesojkriteret e përzgjedhjes te percaktuar nedosje tenderit dhene njoftimin per kontrate dhe deshmon se Komisioni i vlerësimit ka qen jo profesional duke shkelur **nenin 59 par. 1 te LPP-se dhe nenin 59 par. 4 te LPP-se** me rastin e vlerësimi te tendereve ne kete AP.

Te gjitha keto fakte dhe deshmi te ofruar nga ana jone jane profesional dhe nuk mund te kontestehoen nga ansje ZPP – njohes i fushes se prokurimit sepse nuk ka logjik dhe as kuptim te jene ndryshe sepse shkelen standardet dhe rregullat profesional te LPP-se, prandaj arsyetimet e dhena nga jone jane te mbeshtetuar ne dispozite ligjore ashtu sic kemi potencuar ne kete KpR, duke i mundesuar AK – ZPP te aprovoj kerken tone dhe te shqyrtoj kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesional ne funksion te qellimit te prokurimit per kete aktivitet te prokurimit dukek rekomanduar NE si GOE te vetemit te pergjgjsheme dhe me cmime brenda vleres se parashikuar te percaktuar nga vete AK-NJK ne kete procedure prokurimi, duke caktuar nej Komision te vlerësimit ne pajtim me **nenin 59 par. 1 te LPP-se** dhe rekomanduar per kontrate vetem GOE qe i plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe eshte profesional ne ekzekutimin e kësaj kontrate duke realizuar shërbime profesionale dhe ne funksion te qyteteve te Komunes se Vushtrrise, duke mbrojtur edhe interesin publik per te marr ekto shërbime qyqaret per kushtet e veshtira ne rast te reshjeve te bores.
.

AK me rastin e rekomandimit per dhenie te kontrates GOE: **NNP HYSNI & POUK Group SHpk** te cilet jane te papergjegjshem per kete aktivitit te prokurimit AK - komisini i vlerësimit kane shkelur nenin **1, 2, 7, 52, 53, 59, 60, 61 dhe 72 te LPP-së,** per faktin se kane vepruar ne kundershtim me dispozitat ligjore te LPP-se ashtu sic potencuam me larte, prandaj kerkojme nga AK – ZPP – NJK te marrin pergjegjesi dhe te veprojn ne te kunderten ne do te detyrohemi te drejtohemi instituconeve relevante.

PROVE: *Konsultimi i dispozitave ligjore te LPP-se te faktuar dhe argumentuar ne kete KpR tani Ankese ne OSHP*

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se AK – ZPP ka shkelur **Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së** e parasheh qarte qe "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët*

ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar ketë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosovës.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga ESH si dhe nga OSHP-ja qe te merr:

V E N D I M

APROVOHET, **si e bazuar** ankesen nga GOE: **ECO CLEAN & Energy;Dardania Shpk; Ibrahim Kurrumeli B.I.**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM** dhe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore te LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjitha palët qe kane marr pjesë nekëtë aktivitet te prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet material janë te mëdha ne përgatitjen e këtij tenderi ne aspektin material si dhe shpenzimet e deri tanishme përkëtë AP arrijnë vlerën rreth **4425.00 €** si duke na mohuar një norme të fitim **PERAFERISHT 5%** te vlerës te kësaj kontratë, si dhe ne aspektin e reputacionit dhe prestigjit si kompani serioze dhe te përgjegjshëm me çmimin me te ulët.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të **Grupit të O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të **dt. 06.03.2024**, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , **më datën 14.03.2024** bie këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë **Grupit të O.E. " EcoClean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë, e datës 11.03.2024**, për rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, respektivisht **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 06.03.2024** lidhur me aktivitetin e prokurimit : " **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve** ", me **Nr. Prok: VU644 – 23 – 14245 – 2-1-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 168 – 211**
2. **Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 06.03.2024**
3. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka vendosur që , në aktivitetin e prokurimit : " **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve** ", me **Nr. Prok: VU644 – 23 – 14245 – 2-1-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 168 – 211**, të shpërblej me kontratë Grupin e O.E. : **NNP** " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. me seli në Vushtrri.

Në Kërkesën për rishqyrtim të Vendimit të A.K. të dt. 06.03.2024, parashtruar nga Grupi i O.E. " **Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I.**" (në tekstin e mëtejmë Ankuesi), Ankuesi konsideron se me këtë vendim janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 1 – Qëllimi, neni 2 – Fushëveprimi, neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni 51 – Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes, neni 52 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, neni 61 – Tenderët Jo-normalisht të ulët, neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës, neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë si dhe neni 17 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pasi u shqyrtuan pretendimet ankimore të Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar, për arsye se :

Pretendimi ankimor lidhur me mostrajtimin tenderit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratë si tender me çmim jo-normalisht të ulët, sikurse u vlerësua nga A.K., është i bazuar dhe i qëndrueshëm dhe , A.K. në procesin e ri-vlerësimit të tenderëve do të siguroi që tenderi i O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës, përveç se do të ri-vlerësohet në kuptim dhe zbatim të dispozitave të nenit 59 të

LPP-së, tenderi i O.E. do të trajtohet në mes tjerash dhe në kuptim dhe zbatim të dispozitave të nenit 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Gjithashtu, edhe pretendimet tjera të theksuara në Kërkesën për Rishqyrtim, pretendime këto të cilat bazohen në Kërkesat e saktësuar në Dosjen e Tenderit, pjesa Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), neni 9.1 lidhur me nenin 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, si :

- pretendimi nr. 2 lidhur me kërkesën që O.E. duhet të ofroi dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë) në vlerë minimale prej : 216,000.00€ sipas Kërkesë nr. 1 të saktësuar në FTD;
- pretendimi nr. 3 lidhur me mosnoterizimin e dokumentit : " Vlerësimi i Riskut nga një kompani e licencuar nga organi kompetent " (MPMS) , sipas Kërkesës nr. 2 të saktësuar në FTD ;
- pretendimi nr. 4 lidhur me mosnënshkrimin e dokumentit : " CV-i) e inxhinjerit z. Azem Gashi, sipas Kërkesës nr. 3 të saktësuar në FTD ;
- pretendimi nr. 5 lidhur me numrin e punëtorëve teknik ndihmës, sipas Kërkesës nr. 4 të saktësuar në FTD ;
- pretendimi nr. 6 lidhur me mos regjistrimin e dy traktorëve, sipas Kërkesës nr. 5 të saktësuar në FTD ;

A.K. në procesin e ri-vlerësimit të tenderëve do ti analizoi, vlerësoi dhe njëherë tenderët e pranuar dhe që janë lëndë e aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe do ti trajtoi në kuptim të zbatimi të dispozitave të LPP-së dhe Rregullores ë fjalë dhe, mbi bazën e të gjeturave të konstatuara, do të vendoset në mënyrë meritore.

Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit të saktësuara në Kërkesën për Rishqyrtim, me theks të veçantë pretendimi lidhur me mostrajtimin e tenderit sa i përket çmimit n Jo-normalisht të ulët , por edhe pretendimet tjera janë pjesërisht të bazuara andaj, në procedurë të mëtejmë A.K. do të luaj rrolin aktiv në procesin e ri-vlerësimit të tenderëve duke u kujdesur dhe në zbatimin e plotë dhe të drejtë të dispozitave ligjore të LPP-së dhe të Rregullores, posaçërisht nenin 1 - Qëllimi, nenin 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti, nenin 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi, nenin 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëvesi dhe nenin 61 – tenderi me çmim jo-normalisht të ulët, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë aprovuar si pjesërisht të bazuara.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 168/2023, datë 14.03.2024

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

Azize Krasniqi

u.d. e ZPP-së

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria për Prokurim Publik – Vushtrri

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë : **Grupit të O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë " me seli në Podujevë**, Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjekt në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **04.04.2024**, merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin e subjektit në **procedure: Grupit të O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit : **" Mirëmbajtja dimërore e rrugëve "**, me **Nr. Prok: VU644 – 23 – 14245 – 2-1-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 168 – 211**
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues - Drejtorisë për Prokurim Publik për anulim të aktivitetit të prokurimit në bazë të **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 29.03.2024**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i vlerësimit të tenderëve, respektivisht procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, më dt. 05.03.2024 ka marrë vendim sipas të cilit ka rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e O.E. : NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. me seli në Vushtrri.
Kundër vendimit në fjalë është ushtruar Kërkesë për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues, nga subjekti në procedurë : **Grupit të O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë** ndërsa, Autoriteti Kontraktues me vendimin e tij të dt. 14.03.2023 duke vendosur lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të Grupit të O.E. në fjalë ka vendosur që të aprovoi Kërkesën për Rishqyrtim si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e ka kthyer në Ri-vlerësim.
Autoriteti Kontraktues mbi bazën e Vendimit të tij , në procesin e ri-vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, përveç ri-vlerësimit të tenderëve, si palë me interes juridik, tenderin e Grupit të O.E. NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. e ka trajtuar përveç në kuptim dhe zbatim të dispozitave të nenit 59 të LPP-së dhe në zbatim të dispozitave të nenit 72 dhe 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 paragrafi 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , ndërsa tenderin e Ankuesit , në mes tjerash, e ka trajtuar dhe ri-vlerësuar dhe në kuptim dhe zbatim të dispozitave të nenit 38 duke zbatuar analogjinë me nenin 41 paragrafi 41.4 (çmim jo-normalisht i ulët, por në rastin tonë çmim jo-normalisht i lartë në pozicione të caktuara) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke kërkuar sqarime, informacione dhe / apo dokumente të cilat është vlerësuar se mungojnë në aplikacionet gjegjësisht tenderët e Operatorëve Ekonomik.
Në kuptim të kësaj që u theksua më lartë në këtë Vendim dhe në zbatim të Vendimit të A.K. të dt. 14.03.2024, për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit, A.K. nga Grupi i O.E. NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. , me shkrim, përmes Platformës Elektronike, në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-

së lidhur me nenin 38 paragrafi 38.5 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ka kërkuar që të dorëzoj të plotësuar dhe / ose kompletuar – qartësuar dokumentet dhe / ose informacion e paraqitura në aplikacionin e tij, veçanërisht lidhur me Kërkesat e saktësuar në Dosjen e Tenderit, pjesa Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), neni 9.1 lidhur me nenin 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, si janë : Kërkesa nr. 1 - dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë) në vlerë minimale prej : 216,000.00€, Kërkesa nr. 2 – noterizimi i dokumentit " Vlerësimi i Riskut nga një kompani e licencuar nga organi kompetent " (MPMS), Kërkesa nr. 3 - nënshkrimi i CV-së nga Ing. kryesor respektivisht Menaxheri i Kontratës, ndërsa në përgjigjen e tij Grupi i O.E. në fjalë ka dorëzuar po përmes Platformës elektronike, dokumentet e plotësuara dhe ose shpjegimet e kërkuara, të cilat nga procesi i rivlerësimit kanë rezultuar si dokumente të pranueshme dhe të mjaftueshme për vendimmarrje të drejtë.
Gjithashtu, po nga Grupi i O.E. NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k, me shkrim, përmes Platformës Elektronike, në zbatim të dispozitave të nenit 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 paragrafi 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik A.K. ka kërkuar që, duke bërë një ndarje të elementëve përbërës të tenderit, të ofroi, me shkrim, një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit të tij dhe të ofroi shpjegime dhe / ose informacione lidhur me pyetjet e parashtruara si në Kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Edhe në këtë Kërkesë, Grupi i O.E. në fjalë, me shkrim dhe përmes Platformës Elektronike, ka dorëzuar përgjigjen, përmes së cilës janë ofruar informacione relevante, të cilat nga procesi i ri-vlerësimit nga A.K. janë vlerësuar si shpjegime bindëse, të argumentuara si : ka qenë kontraktor i A.K. në vitin 2022/2023, se ka përfunduar me sukses kontratën, se në stok ka sasi të konsiderueshme të materialeve të pashpenzuara, të mbetura në stok nga Kontrata e mëparme, si krip, rërë etj , andaj si të tilla këto fakte janë pranuar si objektivisht të pranueshme dhe bindëse për A.K. ndërsa, tenderi i Grupit të O.E. është radhitur në mesin e tenderëve të përgjegjshëm duke u trajtuar njëjtë me tenderët tjerë në proces.

Ndërsa, duke ri-vlerësuar tenderin e Grupit të O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " saktësisht duke analizuar, vlerësuar dhe krahasuar çmimin e tenderit të Grupit të O.E. në fjalë, A.K. ka ardhur në konkludimin se, çmimi i tenderit të Grupit të O.E., në dokumentin : Përshkrimi i pozicioneve dhe çmimet " pozicioni nr. 13 " Kujdestaria aktive " në shumë prej : 34,320.00€ , për Autoritetin Kontraktues objektivisht paraqet çmim jo normalisht të lartë krahasuar me çmimin respektivisht mjetet financiare të parashikuara nga Autoriteti Kontraktues, për pozicionin nr. 13 " Kujdestaria aktive " Sikurse ka vlerësuar më tej A.K., ky çmim për A.K. ka qenë jo i çartë dhe ligjërisht i papranueshëm për faktin se është substancialisht mbi vlerën e parashikuar nga A.K. dhe lidhja eventuale e Kontratës me këtë vlerë të pozicionit në fjalë do të rezultonte me kontratë të dëmshme për Autoritetin Kontraktues, andaj këtë përgjegjësi, ligjërisht, Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar si të pa përballueshme, si çmim manipulativ. Duke qenë se, si A.K. kemi vlerësuar se lidhja eventuale e kontratës së dëmshme për A.K. paraqet shkelje ligjore, marrë parasysh se me këtë çmim objektivisht dëmtohet buxhetit dhe nuk arrihet përmbushja e parimit thelbësorë të LPP-së, " Vlera për Paranë " A.K. ka vendosur që, në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të kërkoj nga Grupi i O.E. që, mbi bazën e të cekurave si më lartë dhe që të mundë ta vlerësojmë në mënyrën e duhur tenderin e Grupit të O.E në fjalë, të na sqaroj në detaje të arsyeshme bazën ekonomike dhe arsyeshmërinë ekonomike – financiare dhe faktorët tjerë relevant që kanë pasur në vlerësim dhe / ose konsideratë me rastin e ofrimit të çmimit të njësisë prej 52.00€/orë respektivisht vlerën e përgjithshme prej : 34,320.00€ për pozicionin në dokumentin : Përshkrimi i pozicioneve dhe çmimet " pozicioni nr. 13 " Kujdestaria aktive " **Lidhur me Informatën e kërkuar Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë përgjigje në afatin kohorë të specifikuar nga A.K. andaj, në zbatim të dispozitave të nenit 38 pika 38.7 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ka vendosur ta refuzoi tenderin e Grupit të O.E.**
Njoftimi mbi vendimin e A.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, bazuar në nenin 42 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, është publikuar ne Platformën Elektronike më dt. 29.03.2024.
Kundër Vendimit të A.K. të dt. 29.03.2024 Grupi i O.E. " Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & "Ibrahim Kurrumeli B.I." (në tekstin e mëtejmë Ankuesi) ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim. Në Kërkesën për rishqyrtim Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 29.03.2024, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht nenin 1 – Qëllimi, nenin 2 - Fushëveprimi, nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 7

– Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, nenin 10 – Mjetet për promovimin e Transparencës, nenin 51 – Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes, nenin 52 parag. 3 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, nenin 60 – Kriteret për dhënien e kontratës, 61 – Tenderët Jo-Normalisht të ulët, nenin 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 17.26 dhe 17.27 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi pretendimin e Ankuesit të parashtruar në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Sipas nenit 1 të LPP-së , A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuara, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejtë të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike të A.K. , neni 6 – ka pasur për qëllim që të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren – shfrytëzohen në mënyrë më ekonomike duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ndërsa neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë në mënyrë meritore. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 29.03.2024 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e O.E. NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k është marrë në mes tjerash edhe në zbatim të nenit 59 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .

Lidhur me pretendimin e Ankuesit për papërgjegjshmërinë e O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës A.K. edhe më lartë në këtë Vendim ka sqaruar se sa i përket tenderit me çmim Jo-normalisht të ulët A.K., në zbatim të dispozitave të nenit 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 paragrafi 41.2 dhe 41.3 të Rregullores e ka trajtuar tenderin konform dispozitave të cituara dhe O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës me sukses dhe në pajtim me dispozitat e nenit 61 të LPP-së me shkrim, përmes Platformës Elektronike, ka ofruar sqarimet e kërkuara, të cilat sikurse është vlerësuar dhe sqaruar prej A.K. kanë qenë sqarime të mjaftueshme, të besueshme dhe mbi këtë bazë A.K. e ka radhitur në mesin e tenderëve të përgjegjshëm dhe e ka trajtuar si të tillë deri në vendimmarrje përfundimtare, andaj pretendimet e Ankuesit lidhur me çmimin Jo-normalisht të ulët të tenderit të Grupit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës janë vlerësuar si të pabazë dhe si të tilla janë refuzuar.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se Grupi i O.E. i rekomanduar me dhënie të kontratës nuk përmbushë vlerën e referencave për shërbime dhe / ose punë të ngjashme ashtu sikurse është saktësuar në FTD – kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale, pika 1, A.K. sqaron se në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 38 të Rregullores ka trajtuar tenderin e Grupit të O.E. duke kërkuar referenca për projektet e listuara në Listën e projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit para publikimit të Njoftimit për Kontratë, ndërsa O.E. në përgjigje të kërkesës të A.K. me shkrim, përmes Platformës Elektronie, ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara, të cilat A.K. i ka vlerësuara si të mjaftueshme dhe në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Me këtë rast A.K. ka pasur parasysh faktin se Grupi i O.E. ka dëshmuar se në vitin 2022/2023 me A.K. – Komunën e Vushtrrisë ka realizuar me sukses kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, se Grupi i O.E. ka në dispozicion staf teknik, ingjenjerik, makineri të rregullt dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e shërbimeve të natyrës së njëjtë me titullin e aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Posedimi i makinerisë së mjaftueshme dhe të rregullt si dhe stafit teknik sikurse ka vlerësuar A.K. janë kërkesat thelbësore të cilat tenderuesi duhet ti përmbushë, dhe një gjë e tillë nga tenderuesi është përmbushur përmes dorëzimit të dëshmive të dorëzuara dhe / ose kërkuara, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i paqëndrueshëm respektivisht i pa bazuar.
Lidhur me pretendimin e Ankuesit se Grupi i O.E. nuk ka dorëzuar të noteruar dokumentin " Vlerësimi i rriskut "A.K. ka vlerësuar se kjo paraqet një devijim jo substancial dhe jo largim dhe / ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e A.K. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë pajtueshmëri me rregullat, andaj A.K., në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 38 të Rregullores, nga Grupi i O.E. me kërkesë me shkrim përmes Platformës Elektronike, ka kërkuar të dorëzoi të noteruar dokumentin " Vlerësimi i riskut " të njëjtin dokument të dorëzuar në Dosjen e Tenderit me rastin e aplikimit pa asnjë ndryshim më të vogël, por vetëm me vulë të noterit, ndërsa O.E. në përgjigje të kërkesës të A.K. ka dorëzuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dokumentin e kërkuar, po ashtu përmes Platformës Elektronike, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i paqëndrueshëm respektivisht i pa bazuar.

Edhe pretendimin tjetër i Ankuesit se Grupi i O.E. nuk ka dorëzuar të nënshkruar dokumentin " CV-i " të Inxhinjerit – Menaxherit të Kontratës, z. Azem Gashi, A.K. ka vlerësuar se edhe ky rast paraqet një devijim jo substancial dhe jo largim dhe / ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e A.K. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë pajtueshmëri me rregullat. Me këtë rast A.K. ka patur parasyshë se z. Gashi është staf i rregullt i O.E., se është i paraqitur në Administratën Tatimore, se me O.E. ka kontratë të rregullt pune, andaj A.K. edhe në këtë rast, në zbatim të dispozitave të nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 38 të Rregullores, nga Grupi i O.E. me kërkesë me shkrim përmes Platformës Elektronike, ka kërkuar të dorëzoi të nënshkruar prej z. Gashi dokumentin " CV-i " të njëjtin dokument të dorëzuar në Dosjen e Tenderit me rastin e aplikimit pa asnjë ndryshim më të vogël, por vetëm me nënshkrim të z. Gashi, ndërsa O.E. në përgjigje të kërkesës të A.K. ka dorëzuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dokumentin e kërkuar, po ashtu përmes Platformës Elektronike, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i paqëndrueshëm respektivisht i pa bazuar.
Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. në listën e stafit ka të evidentuar edhe staf inxhnjerik dhe si të tillë stafi i nxhinjerik nuk duhet marrë në konsideratë si staf teknik, dhe po ashtu se nuk ka staf të mjaftueshëm, respektivisht nuk i ka të dëshmuar 20 punëtor në Listën e stafit, A.K. sqaron se Lista e stafit është e dorëzuar në rregull, se dëshmitë e dorëzuara, kontratat e punës të stafit të listuar janë dorëzuar të rregullta dhe tregojnë qartë se O.E. e përmbushë edhe këtë Kërkesë, ndërsa sa i përket kontratës së punës të Arbnor Shabani, A.K. ka vlerësuar, bazuar në sqarimin e O.E. se, biznesi i O.E. ka edhe staf familjar, dhe në mesin e tyre është edhe Arbnor Shabani, ndërsa mungesa e nënshkrimit në kontratë është vlerësuar devijim jo substancial dhe jo largim dhe / ose kufizim thelbësor nga Kërkesat teknike të saktësuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, që nuk afekton parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, nuk kufizon të drejtat e A.K. ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës, se nuk shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë pajtueshmëri me rregullat, andaj edhe ky pretendim i Ankuesit është hedhur poshtë si i pa bazuar.
Ndërsa, lidhur me pretendimin se dëshmitë lidhur me Traktorët nuk janë të plota pasi që traktorët nuk janë të regjistruar, nga procesi i ri-vlerësimit A.K. edhe një herë vlerësoi dhe erdhi ne përfundim se Grupi i O.E. e përmbushë këtë kërkesë sa i përket çështjes se regjistrimit te traktorëve, pasi që Komisioni i rivleresimit dhe A.K. erdhën në përfundimin dhe vlerësimin se të regjistruara janë kërkuar vetëm automjetet, ndërkaq qe traktori nuk bene pjese ne grupin e automjeteve pasi qe konsiderohen mjete pune dhe si të tilla nuk kërkohen të jenë të regjistruar.
Çështjet tjera te ngritura nga Ankuesi ne fazën e pare janë përmbushur dhe / ose zgjidhur nga O.E. bazuar ne kërkesën e A.K. mbi bazën e zbatimit te dispozitave te nenit 72 lidhur me nenin 59 te LPP-se.

Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit të saktësuar në Ankesën e tij janë të pabazuara, të pasakta. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 29.03.2024 për të rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e O.E. NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi sepse nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 52 - Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Udhëzim Juridik :

Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në OSHP, në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-së lidhur me nenin 9 të Rregullave për parashtrimin e ankesës pran OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 168/2023 - datë: 04.04.2024

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

u.d. e ZPP-së

Azize Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 96/24
Dt. 12.03.2024

Në bazë të nenit 130 pika 1 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 108/A paragrafi 2 të Ligjit për prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, për shkak se Autoriteti Kontraktues ka pranuar **Kërkesë për Rishqyrtim të Njoftimit mbi Vendimin e A.K.,** në aktivitetin e prokurimit: **" Mirëmbajtja dimërore e rrugëve "** , me dt. **12.03.2024**, nxjerrë:

K O N K L U Z I O N
Për Pezullimin e përkohshëm të Aktivitetit të Prokurimit

I . PEZULLOHET përkohësisht zbatimi i aktivitetit të prokurimit lidhur me projektin: **" Mirëmbajtja dimërore e rrugëve " Prok: VU644 – 23 – 14245 -2-1-1 / Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 168 – 211**, për shkak se Autoriteti Kontraktues ka pranuar Kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues.

II. Ky Konkluzion hynë fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes, ndërsa do të zgjasë deri në marrjen e një vendim të plotfuqishëm nga A.K., lidhur me këtë çështje.

III. Konkluzioni publikohet në platformën elektronike në adresën: Http:e-prokurimi.rks-gove.net/

Arsyetim

Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Blerësit, për nevoja të saja ka iniciuar dhe zbatuar aktivitetin e prokurimit për blerjen e shërbimeve sipas projektit: **" Mirëmbajtja dimërore e rrugëve " Prok: VU644 – 23 – 14245 -2-1-1 / Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 168 – 211**

Bazuar në Kërkesën/at e datës **11.03.2024 të** Op. Ek. për rishqyrtim të **Njoftimit mbi Vendimin e A.K. të dt. 06.03.2024**, mbështetur në dispozitat e nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, citat: " *Dorëzimi i një Kërkese për shqyrtim* obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloi zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar" mbarim citati, në funksionin e Menaxherit të Prokurimit pran Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, kamë nxjerrë Konkluzionin me efektet si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesë e veçantë.

Azize Krasniqi

u.d. e ZPP-s

KOMUNA E VUSHTRRISË

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☒ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 27.12.2023

Nr i Prokurimit	**VU644-23-14245-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **KOMUNA E VUSHTRRISË**		
Adresa Postare: **SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173**		
Qyteti: **VUSHTRRI**	Kodi postar: **42000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Person pergjegjes:Ilmi Azemi** **Persni kontaktues:Azize Krasniqi**	Telefoni: **038/200-42403**	
Email: **prokurimi.vushtrri@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*:		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Mirëmbajtja dimërore e rrugëve

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ **Punë**	☐ **Furnizime**	☒ **Shërbime**
☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Vendodhje e shebimeve do te behet ne terirotin e komunes se vushtrris dhe sipas kerkeses se njesisi kerkuse .

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 24

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Ka te bej me mirembajtjen dimnore e rrugve lokale per ma shume informata referoju aneksit nr.1 te dosja e tenderit

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

74740000-8

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ **Jo** ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 180,543.80

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Sherbime per mirembajtjen dimnore te rrugve lokale do te ralizohet sipas nevojave te njesis kerkuse.

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % (Dhjetë përqind) e vlerës së përgjithëshme të kontratës me afatë validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Dokumenti - Polisa e sigurim apo dokument banka të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.** % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:

Ne baze te dispozitave te LPP
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës **Po** ☐ **Jo** ☒ ***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkuruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit, duhet të dorëzohet në (Origjinal) Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie te Kontratës. 2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në kopje 3. Një vërtetim nga " regjistri gjyqësorë " apo në mungesë të tij një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themlimit tuaj , që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të merrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose kopje .**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të Themelimit**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar, duhet të dorëzohet kopje**
2. Çertifikata e TVSH-së.	**2. Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **Kërkesa 1 .Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 220,000.00 Në**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një**

rast te ofertimit si Grup i OE-ve ,lideri i grupit duhet ta përmbush së paku 60% të vlerës se kërkuar	**auditor i licencuar i pavarur Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale 216,000.00 Ne rastet e ofertimit si Grupi I OE-ve, nga lideri I grupit kerkohet qe ta permbush min 60% te vlerese se kerkuar .	**Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje me sukses te punëve.**
Kerkesa 2.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar nga organi kopentent (MPMS) . Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të këtë kryer vlersimin e rriskut	**Deshmia 2.Vlersimi i rriskut per kompani te deshmohet me vertetim nga nje kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS) se ka kryer vlersimin e rriskut konform ligjit 04 L-161 vertetimi duhet te jete i noterizuar) - Liderin**
Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të angazhoj këtë staf profesionale në veçanti, të personit që drejtpërdrejt është përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore; Një (1) Bachelor i Ndërtimtarisë apo master, (drejtimi Konstruktiv), i emëruar me vendim menaxher dhe përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit.	**Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listes duhet të i bashkangjiten këto dëshmi CV-ja e nënshkruar nga inxhinieri; Diploma, duhet të jetë e noteruar; Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi si dhe e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëdhënësi. Vendimi mbi emrimin e menaxherit të projektit i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur.**
Kërkesa 4. Operatori ekonomik dueht të ketë stafë teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum nezet (20) Puntorë teknik - ndhimës.	**Dëshmia 4. Lista e punëtorëve teknik me të dhënat e tyre e nënshkruar dhe e vulosur, të cilët duhen dëshmuar me Kontratë të punës apo Parakontratë të punës të nënshkruar nga Punëdhënësi dhe Punëmarrësi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi.**
Kerkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT	**Dëshmia 5. Lista për makanizimin dhe paisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe listes duhet ti bashkangjitet Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen deklaron se i posedon makinerit dhe paisjet e listuara ne Aneksin nr.7 te DT_s .ndërsa, makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me njërën prej këtyre dëshmive kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata apo marrëveshje mbi qiramarrjen të cilës duhet ti bashkangjitet edhe dokumenti i automjetit me të cilën dëshmohet pronësia në emër të qiradhënësit,Vërejtje Automjetet duhet të jenë me librezë dhe me regjistrim valid.**

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ **Jo** ☒

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve **Po** ☐ **Jo** ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ **E hapur**
☐ **E kufizuar**
☐ **Konkurruese me negociata**
☐ **Kuotim i Çmimit**
IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)* Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)* Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme **Po** ☐ **Jo** ☐ në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata **Po** ☐ **Jo** ☐
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë **Tenderët fillestar është**:
IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒ Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët** *ose* ☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

Po ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:*

data **05.02.2024** ***koha*** **14:00:00** ***vendi*** **Përmes Platëformës së sistemit të E-prokurimit**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:

☐ **Po** ☒ **Jo**

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **1,805.00€ (Njëzetedymijëepesëqind pikë zerzero euro)**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **150** *apo* muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **120** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 05.02.2024 koha 14:00:00 vendi

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes

së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. *Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 63.1.2 pika (a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve

(nga procesi i Ri-vlerësimit të tenderëve)

Nr. i prokurimit[1]	**VU644-23-14245-2-1-1**
Nr i brendshëm	**VU644-23-168-211**

Nr. rend.	Lënda: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	" Çlirimi 99 "sh.p.k. & " Fidaie Bytyqi B.I. "	166,809.52€
2.	NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k.	89,592.00€
3.	" Eco Clean & Energy " & " Dardania "sh.p.k. & " Ibrahim Kurrumeli B.I. "	169,096.00€

Rezultati i aktivitetit të prokurimit nga procesi i Ri-vlerësimit të tenderëve :

Duke pasur parasysh:
- treguesit e çmimeve të tenderuesve, kriterit për dhënie të kontratës se Tenderues fitues është ai që ka ofruar " tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët " me kontratë shpërblehet, me sa vijon :

Komuna e Vushtrrisë **shpërblen** me kontratë : **G.O..E.; NNP " Hysnia " & " POUK Group "sh.p.k. – Vushtrri ,** në vlerë totale të parashikuar të kontratës në shumë prej : **89,592.00€.**

Data: 28.03.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: Azize Krasniqi

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIK OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [1]

14 Nr. 131/24

Dt. 28.03.2024 - Vushtrri

Nga : Komuna e Vushtrrisë, Rr. " Isa Boletini " nr. 44 - Vushtrri

Për : **Dardania "sh.p.k. & „ Eco Clean & Energy „ & "Ibrahim Kurrumeli B.I. " me seli në Podujevë z. Ekrem Gashi**

Nr. i prokurimit:	**VU644**	**2**	**3**	**142**	**4**	**5**	**2**	**2**	**1**
Nr. i brendshëm:	**VU644**	**2**	**3**	**1**	**6**	**8**	**2**	**2**	**1**

Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

I/e nderuar(a) Z/Znj : **z. Gashi,**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak se :

Bazuar në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, si A.K. kemi konsideruar se tenderi Juaj respektivisht çmimi i shërbimit të pozicionit në dokumentin : Përshkrimi i pozicioneve dhe çmimet " pozicioni nr. 13 " Kujdestaria aktive " në shumë prej : 34,320.00€ , për Autoritetin Kontraktues objektivisht paraqet çmim jo normalisht të lartë krahasuar me çmimin respektivisht mjetet financiare të parashikuara nga Autoriteti Kontraktues, për pozicionin nr. 13 " Kujdestaria aktive ".

Mbi bazën e këtij vlerësimi, si A.K. kemi konsideruar se tenderi Juaj respektivisht çmimi i " pozicionit nr. 13 " Kujdestaria aktive " në shumë prej : 34,320.00€ për A.K. është jo i çartë dhe ligjërisht i papranueshëm për faktin se është substancialisht mbi vlerën e parashikuar nga A.K. dhe lidhja eventuale e Kontratës me këtë vlerë të pozicionit në fjalë do të rezultonte me kontratë të dëmshme për Autoritetin Kontraktues dhe po ashtu është vlerësuar se këtë përgjegjësi, ligjërisht, Autoriteti Kontraktues nuk mundet ta bartë.
Në Kërkesën për sqarim të A.K. Nr. 125/ 24 të dt. 25.03.2024, të dërguar në mënyrë elektronike përmes Platformës elektronike (e-prokurimi) kemi kërkuar që, mbi bazën e të cekurave si më lartë dhe që të mundë ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, të na sqaroni në detaje të arsyeshme bazën ekonomike dhe arsyeshmërin ekonomike – financiare dhe faktorët tjerë relevant që keni pasur në vlerësim dhe / ose konsideratë me rastin e ofrimit të çmimit të njësisë prej 52.00€/orë respektivisht vlerën e përgjithshme prej : 34,320.00€ për pozicionin 13 " Kujdestaria aktive " të Përshkrimit të Pozicioneve dhe çmimeve"

---

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*

Ju, brenda afatit të saktësuar në kërkesë, A.K. përmes Platformës elektronike, nuk i keni dorëzuar asnjë shpjegim të arsyeshëm të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, duke mos ofruar asnjë informatë të arsyeshme mbi bazën ekonomike dhe arsyeshmërin ekonomike – financiare dhe faktorët tjerë relevant që keni pasur në vlerësim dhe / ose konsideratë me rastin e ofrimit të çmimit të njësisë prej 52.00€/orë respektivisht vlerën e përgjithshme prej : 34,320.00€ për pozicionin 13 " Kujdestaria aktive " të Përshkrimit të Pozicioneve dhe çmimeve.

Rrjedhimisht, për shkak se nuk keni dorëzuar ndonjë shpjegim lidhur me çmimet e ofruara, për shkak se keni rënë në kundërshtim me Kërkesën e A.K. , si A.K. kemi konkluduar se keni vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 paragrafi 2 të LPP-së dhe nenit 38 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , andaj bazuar në dispozitat e nenit 38.6 dhe 38.7 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik mbi bazën e paralajmërimit sipas shkresës – Kërkesës të A.K., nr. 125/24 e dt. 25.03.2024 se, citat : " nëse nuk marrim përgjigje nga Ju mbi pyetjet e parashtruara brenda afatit kohorë të dhënë, tenderi Juaj do të refuzohet " mbarim i citatit, kemi vendosur që tenderi Juaj të refuzohet për arsyet sikurse u theksua më lartë në këtë njoftim.

Udhëzim Juridik :
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

u.d. e ZPP-së

Azize Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14Nr. 132/24
Dt. 28.03.2024

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

Për : **NNP " Hysnia "& " POUK Group "sh.p.k. – Vushtrri**
z. Hysni Shabani

Nr. i prokurimit [2]	**VU644-23-14245-2-1-1**
Nr i brendshëm	**Vu644-23-168-211**

Titulli : Mirëmbajtja dimërore e rrugëve

I/E nderuar z./znj. Shabani

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është ri-vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar ***tenderin me çmimin më të ulët*** si përgjigje ndaj njoftimit të prokurimit publik për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.
Ju jeni Rekomanduar për dhënie të kontratës me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj për një shumë të përgjithshme prej: 89,592.00€
Ky njoftim nuk është definitiv dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuese, deri në një Njoftim tjetër
Njoftimi mbi **Vendimin e Autoritetit Kontraktues** është publikuar në platformën elektronike të prokurimit.

Me respekt,

Azize Krasniqi

u.d. e ZPP-së

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*
[2] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**VU644-23-14245-2-1-1**	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
05.02.2024	**05.02.2024, 14:00:00**	**05.02.2024, 14:00:00**		**3**

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	**Grup i Operatorëve Ekonomik Çlirimi 99 SH.P.K.; Fidaie Bytyçi B.I., Rr.Gustav Mayer Pn, 10010, Prishtinë-Kosovë**	**02/2024**	**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve**	**PO**	**141364.00**	**166809.52**	**JO**
2.	**Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. HYSNIA ; POUK Group SH.P.K., VUSHTRRI, 42000, VËRNICË**	**VU 02-2024**	**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve**	**PO**	**75925.42**	**89592.00**	**JO**
3.	**Grup i Operatorëve Ekonomik ECO CLEAN & ENERGY; DARDANIAA SH.P.K.; IBRAHIM KURRUMELI B.I., LLAPASHTICË E EPËRME, 11000, LLAPASHTICE E EPERME**	**05022024**	**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve**	**PO**	**143301.69**	**169096.00**	**JO**

Komente nga përfaqësuesit e pranishem
Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:
Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda

nuk ka

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Fisnik Qirezi		05.02.2024
Shqipe Haziri Thaqi		05.02.2024

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Ilmi Azemi

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

ALB-SALE-VLORA, SH.P.K
NIPT:K96914205T
Address:Skrofotine ,Vlore-ALBANIA
Tel/Fax:00355 395 30927, 00355 395 30925
imel:albsalevlore@gmail.com
imel: a.mehmetaj.albsale@gmail.com

VLORE date 21/09/2022

PRO-FATURE NR 1

PER : **"DARDANIAA "SHPK**
NR.FISKAL 811289843 **PRISHTINE KOSOVE**

NR	ARTIKULLI	NJ.MATJE	SASI	Euro/Ton	Vlefta /euro
1	KRIPE DETI INDUSTRIALE PER RRUGE	TON	250.00	35	8,750
	SHMA		250.00		8,750.00

INTESA SAN PAOLO BANK DEGA VLORE
SWIFT CODE : **USALALTRVLR**
ACCOUNT : **AL 0520 8260 2600 0006 3035 6353 02** PER LLOGARI TE SUBJEKTIT "ALB-SALE-VLORA " VLORE ,SHQIPERI

ADMINISTRATORI
VILSON CIPI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ALB SALE sh.p.k.
VLORA
VLORE - ALBANIA

Kerkoj qasje sipas nenit 10 LPP

Eco Clean and Energy <muhamet.muqiqi@hotmail.com>

Fri 3/29/2024 9:07 AM

To:Prokurimi Vushtrri <prokurimi.vushtrri@rks-gov.net>

Lidhur me aktivitetin:

Nr[1] i prokurimit	**VU644-23-14245-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve

Kerkojm qasje per sqarimet shtesë nga autoriteti kontraktues dhe pergjigjjet nese ka pasur nga operatoret ekonomik : N.N.P.HYSNIA ; POUK Group SH.P.K., VUSHTRRI, 42000 VËRNICË dhe Grupit të operatorëve ekonomik Çlirimi 99 SH.P.K; Fidaie Bytyçi B.I., Rr. Gustav Mayer Pn. 10010, Prishtinë - Kosovë. ju lutemi qe pasi ditet e shtune, e diele dhe e hene jan pushim dokumentet per qasje te na i dergoni permes e- mailit .

Faleminderit per mirkuptim: